



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Nr. 7236/3 Prot.

Tiranë, më 15.07 2025

Lënda: Kthim përgjigje

“EDILE VESELI – CONSTRUCTION”

Qarku Durrës, Thumanë, Fushë Thumanë, Borizanë, Vend Furore, Zona Kadastrale 1247, Pasuria Nr.1

Në përgjigje të kërkesës suaj regjistruar pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Nr.7236/2Prot., datë 14.07.2025, me lëndë: “Kthim përgjigje”, Ju bëjmë me dije se:

Në bazë të Shtojcave I dhe II, të Ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, për sipërfaqen $S=0.046\text{km}^2$ sipas përcaktimeve të AKBN-së ku citohet se “Sipërfaqja ku ushtrohet aktiviteti mineral i shfrytëzimit ndodhet brenda sipërfaqes së lejes minerare të shfrytëzimit me Nr.9118/1Prot., date 10.08.2018 me Akt – Miratimi Nr. 1256/1, nuk duhet t'i nënshtrohet Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, pasi është sipërfaqe e shfrytëzuar.

Ju informojmë se aplikimi për Leje Mjedisit Tipi A ose B kryhet sipas përcaktimeve të kreut II Leje Tipi A ose kreut III Leje Tipi B, të VKM Nr.419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisit të tipave A dhe B, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, i ndryshuar.

Operatori i dërgon Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, kërkesën, nëpërmjet QKB-së, sistemit online, referuar Ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM Nr.538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” i ndryshuar.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Arta Dollani

